



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237736

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608681

AC-I-23-0424

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

R H, nga fshati Ll, Podujevë.

Kundër

E paditura

NSH, FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson,
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë,
Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5992 të datës 14 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5992 të datës 14 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Reathanat procedurale dhe faktike

Me datë 26 gusht 2014, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0296 i datës 04 gusht 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën e pa përcaktuar. Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi ka punuar për NSH Fan "Zahir Pajaziti", në Podujevë deri me 24 mars 2006, mirëpo ligji relevant i kohës që ishte i zbatueshëm gjatë aktivitetit të ish AKM-së, nuk ka dhënë shprehimisht të drejtë punëtorëve të kërkojnë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e cila e drejtë më vonë njihet me Ligjin nr. 03/L-067 për AKP-në, dhe atë që nga qershori i vitit 2008. Tutje Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se paditësi kërkesën e tij nuk e ka parashtruar në afatin e duhur ligjor në ndonjë Gjykatë apo Autoritet kompetent. Në ankesë paditësi ka pohuar se në NSH ka punuar deri me 24 mars 2006, dhe se NSH-ja i ka borxh lidhur me pagat për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ai pohon se i është drejtuar organeve gjegjëse të NSH-së për realizimin e këtyre pagave, por se kësaj kërkesë nuk i është përgjigjur, duke pohuar se në rastin e tij është shkelur e drejta elementare për ekzistencë, meqë është mbetur pa punë pa fajin e vet. Në ankesë ka kërkuar që të rishqyrtohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe të anulohet si jo ligjor. Bashkë me ankesë ai ka bashkangjitur vetëm kopjen e ankimuar të vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 29 janar 2020, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka sjellë dëshmi për të vërtetuar se ai këto paga i ka kërkuar më herët në ndonjë gjykatë kompetente, andaj kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur në ankesën e tij i cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar. AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk mundet të konsiderohet asnjëherë si pranim i borxhit, duke pohuar se kjo letër ka të bëjë me realizimin e të drejtës nga lista për 20%. Në mbrojtjen në ankesë ajo ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 22 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS e lëshon një urdhër për paditësin me të cilin kërkon prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 05 tetor 2022, paditësi e dorëzoi një parashtesë si përgjigje ndaj urdhrit me të cilin ai ka sjellë vendimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, një kopje të letërnjoftimit dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, por jo edhe ndonjë provë tjetër për ta mbështetur ankesën e tij.

Me datë 14 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5992, e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi e kishte barrën e provës bazuar në nenin 42 paragrafi 2 të LDHP-së, ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi relevante që dëshmon ekzistimin e marrëdhënies së punës në NSH, asnjë dëshmi mbi përvojën e punës apo ndonjë dokument apo listë të punëtorëve me të cilën do të vërtetonte kohën e saktë të punësimit dhe stazhin e tij të punës në NSH. Dëshmia e vetme e dorëzuar nga paditësi është vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara lidhur me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës duhet të mbështetet me prova përkatëse, gjë që kjo nuk ka ndodhur, andaj i njëjti nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që ti njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës.

Me datë 17 korrik 2023, paditësi e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-5992 të datës 14 qershor 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar është i padrejtë dhe jo ligjor. Paditësi pohon se gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, dhe nuk e ka marrë për bazë faktin se ai ka qenë në punë në NSH deri me 26.09.2006. Andaj nga këto arsye, ky Aktgjykim nuk mund të qëndrojë dhe si i tillë ai duhet të anulohet.

Me datë 04 shtator 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja po ashtu ka pohuar se kërkesa e paditësit është parashkruar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 26 shtator 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe i ka kërkuar që ai të kompensohet për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në të cilën kërkesë paditësi nuk e ka specifikuar shumën e kërkuar. Me ankesën e dorëzuar në Shkallën e I-rë, paditësi përsëri nuk e specifikon shumën të cilën ai e kërkon në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se në kohën e Ligjit të zbatueshëm të veprimit të AKM-së, nuk është përcaktuar kjo kërkesë që mund ti njihet parashtruesit edhe pse ai në bazë të arkivës së ndërmarrjes shihet se ishte në punë në NSH Fan "Zahir Pajaziti", në Podujevë deri në 24 mars 2006. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se kjo kërkesë mund ti njihet parashtruesit vetëm pas qershorit 2008, kur është aprovuar Ligji i AKP-së, gjë që në këtë rast

paditësi nuk e ka përfill afatin ligjor duke mos dorëzuar kërkesën brenda 3 viteve, andaj kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në Shkallën e I-rë ka dorëzuar vetëm vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Paditësit i është dhënë rasti të dorëzojë prova në mbështetje të ankesës edhe me urdhrin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së të datës 22 shtator 2022, i cili këtë urdhër e ka pranuar me 23 shtator 2022.

Paditësi me parashtresën e tij të fundit të datës 05 tetor 2022 të dorëzuar në DHPGJS si përgjigje ndaj urdhrit, ka dorëzuar vendimin e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas, kopjen e Letërnjoftimit dhe asnjë dëshmi tjetër në mbështetje të ankesës. Paditësi nuk ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës, nuk ka dorëzuar Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe po ashtu nuk ka dorëzuar asnjë listë të pagave të NSH-së për periudhën para privatizimit të NSH-së me datë 26 mars 2006.

Rrjedhimisht nga këto arsye, me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duke u bazuar në parimin e barrës së provës nga neni 42.2 i LDHP-së, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit, dhe e ka vërtetuar me të drejtë vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Paditësi po ashtu edhe me ankesën në Shkallën e II-të i ka dorëzuar të njëjtat prova që ishin dorëzuar edhe më herët në Shkallën e I-rë, mirëpo ato nuk janë të mjaftuara. Paditësi nuk ka dorëzuar kopje të Librezës së punës, nuk ka dorëzuar Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, e as nuk ka dorëzuar ndonjë listë të pagave të pa paguara të lëshuara nga menagjmenti i NSH-së.

Prandaj nga këto arsye, në mungesë të provave, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar, dhe vërteton Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore bazuar në nenin 8.1 nënpika 8.1.2 lidhur me nenin 8.3 nënpika 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikim e taksave gjyqësore të KGJK-së.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
